



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-057
Prishtinë, më 15 mars 2016,

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 MARS 2016**

Seancën e kryesoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari i hapi punimet e seancës plenare, të paraparë nga seanca plenare e mbajtur më 10 mars 2016.

Në vazhdim, nënkryetari procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i rekomandimit të Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Nënryetari i njoftoi deputetët se Organi Përzgjedhës i Pavarur për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në bazë të nenit 100, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092, në takimin e mbajtur më 14 mars 2016, ka intervistuar kandidatët e propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e kryetarit dhe të një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Ai më pas theksoi se Organi Përzgjedhës i Pavarur ka konstatuar se pasi asnjëri nga kandidatët e propozuar nga komuniteti serb, nuk i kanë plotësuar kushtet formale sipas Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-092, atëherë Qeveria duhet të bëjë propozim tjetër në lidhje me këtë çështje.

Nënryetari hapi debatin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Për këtë çështje diskutoi deputeti Abdyl Ymeri, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Më tej, nënkryetari hodhi në votim rekomandimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

Në sallë ishin të pranishëm 75 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 40,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Nënryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk miratoi rekomandimin e Organi Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e z. Blerim Dina, kryetar, dhe znj. Vjollca Shala-Kurtishaj, anëtare, të Bordit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

* * *

Nënryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 10:40 minuta.

Nënryetari i Kuvendit

Xhavit HALITI

*Procesverbalin e hartoi: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*